



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETI DHE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

01 Nr. 14946
Br. Br.

Nr. i faq. 1 Data: 10/05
Br. str. Datum:

KAMENICËJA 2024

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 10.05.2024

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe të nenin 12, paragrafi 2 shkronja (d) në lidhje me nenet 14 paragrafi 1 dhe 17 shkronja (c) si dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenit 27 (me theks paragrafët 1 dhe 2) të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënin e Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ndërlidhur me nenet 34 dhe 35 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 07.05.2024 miratoi këtë;

V E N D I M PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK

1. Miratohet Vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik prona e paluajtshme e cila është nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si në vijim:
 - 1.1. Pronat e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 40503 m², sipas certifikatës pronësore P-71107003-00580-0 të datës 02.05.2024, në Zonën Kadastrale Berivojcë, të evidentuara si Pronë Shoqërore në Pronësi të NEWCO XIM STREZOC MAGNESITE MINEL.L.C, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovare e Privatizimit. Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj prone është për realizimin e projektit ndërtimin e fabrikës për Prodhimin e Energjisë Elektrike dhe të Ngrohjes "PRAPASHTICA BIOGAS ENERGY" SH.P.K."
2. Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore lidhur me rregullimin e dokumentacionit teknik, regjistrimin e pronës në librin kadastral si dhe çështje e veprime tjera të nevojshme obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.
4. Per zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.
5. Parcela e cekur në pikën 1.1 të këtij vendimi të bartet në pronësi të Kuvendit Komunal të Kamenicës
6. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.

